# CATCH-22

Alienët nga Ballkani Perëndimor në BE

# CATCH-22

Alienët nga Ballkani Perëndimor në BE

Tetor 2020, Prishtinë

**Titulli i publikimit:**
CATCH-22: Alienët nga Ballkani Perëndimor në BE

**Publikuar nga:**
Instituti i Kosovës për Politikat Evropiane

**Vendi dhe koha e publikimit:**
Prishtinë, Tetor 2020

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

# PËRMBAJTJA


Hyrje 6

Përmbledhje Ekzekutive 7

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE në 2019, sipas vendeve 8

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE në 2019, sipas % popullatës 9

Shqipëri vs të gjithë 2019 10

Top tre vende të BE-së me numër më të madh të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor me qëndrim ilegal në 2019, total 11

Top tre vende të BE-së me numër më të madh të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor me qëndrim ilegal në 2019, sipas vendeve 12

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas vendeve 13

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas % popullatës 14

Shqipëri vs të gjithë 2009-2019 15

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas viteve 16

# HYRJE

Catch-22 është situate paradoksale ku individi ballafaqohet me një dilemë nga e cila nuk ka zgjidhje ideale pasi që çfarëdo vendimi që individ merr nuk do arrihet rezultati i dëshiruar.

Sipas Raportit të Dytë Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019" të hartuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT) dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN) 79% të rinjve kanë shprehur dëshirën për të ikur nga vendi. Po i njëjti hulumtim ka gjetur se 73% e shohin problemin e punësimit si më shqetësuesin për ta.

Mungesa e perspektives ekonomike për të rinjtë e Shqipërisë është faktor kyç i cili i shtyn ata për tu larguar nga vendi. Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të ballafaquar në njërën anë, me një situatë të vështirë politike dhe ekonomike në vendet e tyre, dhe në anën tjetër me sfidat e shumta për të migruar drejt BE-së, e gjejnë vetën në dilemën klasike "catch-22".

Në këtë hulumtim kemi tentuar të kuptojmë trendët kyçe sa i përket numrit të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor me qëndrim ilegal në BE në periudhën 2009-2019.

Ky publikim është vazhdimësi e hulumtimeve tona sa i përket migrimit të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së:

- Statistikat e azilit në BE (prill 2019);
- Ikja e Madhe (prill 2019);
- Destinacioni Shengen (maj 2019)
- Migrimi i Ballkanit Perëndimor drejt BE-së: dhe rasti kurioz i Shqipërisë (nëntor 2019);
- Azilkërkuesit nga Ballkani Perëndimor në BE 2009-2019 (korrik 2020);
- Viti më i mirë: Shengen statistikat për Kosovën 2019 (korrik 2020).

Informatat e prezantuara në këtë studim janë të bazuara mbi të dhënat e EUROSTAT-it dhe përkufizojnë "BE-në" në kuptimin e 28 vendeve anëtare (përfshirë Mbretërinë e Bashkuar).

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2019 gjithsej 66,325 qytetarë të Ballkanit Perëndimor ishin zënë duke qëndruar ilegalisht në BE – një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2018. Në këtë rritje ka kontribuar kryesisht Shqipëria.

Në vitin 2019, 37,460 qytetarë të Shqipërisë ishin zënë duke qëndruar ilegalisht në BE. Kjo është më shumë se numri i qytetarëve të të gjitha vendeve të tjera, marr së bashku. Shprehur ndryshe, 1.3% të popullatës së Shqipërisë është zënë me qëndrim ilegal në BE në vitin 2019.

Top tre vende të BE-së ku janë zënë qytetarë të Shqipërisë duke qëndruar ilegalisht janë: Greqia (10,030), Gjermania (7,480) dhe Franca (4,430).

Në rastin e Kosovës gjithsej 4,335 qytetarë janë zënë duke qëndruar ilegalisht në BE gjatë vitit 2019. Ky ishte niveli më i ultë historik. Top tre vende të BE-së ku janë zënë me qëndrim ilegal qytetarë të Kosovës janë: Gjermania (2,165), Franca (620) dhe Kroacia (465).Top tre vende të BE-së ku janë zënë duke qëndruar ilegalisht qytetarët e Ballkanit Perëndimor në vitin 2019 janë: Gjermania (20,015), Greqia (10,130) dhe Hungaria (7,925).

Nëse analizojmë këto të dhëna në një perspektivë më të gjatë kohore 2009-2019, Shqipëria përsëri udhëheq rajonin për nga numri i qytetarëve me qëndrim ilegal në BE. Në periudhën 2009-2019 gjithsej 780,950 qytetarë të Ballkanit Perëndimor ishin zënë duke qëndruar ilegalisht në BE. 415,745 nga këta kanë qenë nga Shqipëria. Kjo është më shumë se numri i qytetarëve të të gjitha vendeve të tjera, marr së bashku. Shprehur ndryshe, 14.5% të popullatës së Shqipërisë është zënë me qëndrim ilegal në BE në 2009-2019.

Në rastin e Kosovës gjithsej 145,680 qytetarë janë zënë duke qëndruar ilegalisht në BE gjatë periudhës 2009-2019. Shprehur ndryshe, 8.1%% të popullatës së Kosovës është zënë me qëndrim ilegal në BE në 2009-2019. Kjo e bënë Kosovën vend i dytë në Ballkanin Perëndimor për nga numri i qytetarëve të zënë me qëndrim ilegal në BE gjatë periudhës 2009-2019.

# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2019)

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE në 2019, sipas vendeve (Burim: EUROSTAT)*



# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2019)

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor me qëndrim ilegal në BE në 2019, sipas % popullatës (Burim: EUROSTAT)*



# SHQIPËRIA VS TË GJITHË 2019

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor me qëndrim ilegal në BE në 2019*
*(Burim: EUROSTAT)*

**37,460**



**28,865**







# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2019)

*Top tre vende të BE-së me numër më të madh të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në 2019, total (Burim: EUROSTAT)*



# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2019)

*Top tre vende të BE-së me numër më të madh të qytetarëve të Ballkanit të zënë me qëndrim ilegal në 2019, sipas vendeve (Burim: EUROSTAT)*



# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2009-2019)

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas vendeve (Burim: EUROSTAT)*



# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2009-2019)

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas % popullatës (Burim: EUROSTAT)*



# SHQIPËRIA VS TË GJITHË 2009-2019

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE në 2009-2019 (Burim: EUROSTAT)*



# QËNDRIMI ILEGAL NË BE (2009-2019)

*Qytetarët e Ballkanit Perëndimor të zënë me qëndrim ilegal në BE 2009-2019, sipas viteve (Burim: EUROSTAT)*



(faqe qëllimisht lënë zbrazët)